



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 17
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303
Prishtinë, më 30 maj 2018, në orën 09:30

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Flora Brovina dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Faton Topalli, Bekim Haxhiu dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës tjerë: Ardiane Hasani KDI dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për gjak dhe përbërës të gjakut,
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për gjak dhe përbërës të gjakut,

Kryetarja, tha se para jush keni raportin me propozim amendamente te grupit punues per shqyrtimin e projektligjit për gjak dhe përbërës të gjakut. Grupi punues ka mbajtur disa takime ku e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në këtë rast me lejoni që para jush ti prezantoj propozim amendamentet të cilat do ti votojmë një nga një dhe mandej si raport me rekomandime do të dërgojmë për shqyrtim në komisionet e përhershme.

Amendamenti 1

Titulli dhe paragrafi 1. i nenit 1. riformulohen si vijon:

Neni 1 Qëllimi

1. Me këtë ligj rregullohet procedura për dhurimin, marrjen, testimin, përpunimin dhe ruajtjen e gjakut si dhe furnizimin e qytetarëve apo pacientëve me gjak dhe përbërës të gjakut.

Amendamenti 2

Në nenin 2, paragrafi 1, fshihet fjalia,, institucionet e autorizuara transfuzive dhe “.

Amendamenti 3

Në nenin 3, paragrafi 1, fjalia „, kuptimet vijuese “ zëvendësohet me fjalinë „, kuptimin si në vijim”

Amendamenti 4

Në nenin 3, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1.; 1.2;1.10;1.11;1.12; 1.13 ; 1.17;1.18;1.24; 1.25; 1.26 dhe 1.28, fjala,, nënkupton” zëvendësohet me fjalën „është”.

Amendamenti 5

Në nenin 3, paragrafët 1.4. ; 1.5.; dhe 1.6. fjala „personi “ zëvendësohet me fjalën „, qytetari” ndërsa në paragrafin 1.14. fjala „, personi” zëvendësohet me fjalën „, pacienti”.

Amendamenti 6

Titulli i kapitullit II, riformulohet si vijon : **KUJDESI SHËNDETËSOR**

Amendamenti 7

Titulli i nenit 4, riformulohet si vijon „, **Zbatimi i ligjit dhe obligimet e institucioneve”**

Amendamenti 8

Në nenin 4, paragrafi 2, fjala „, shoqëror” zëvendësohet me fjalën „,shëndetësor”.

Amendamenti 9

Në nenin 4, paragrafi 5, riformulohet si vijon :

5. Ministria, të drejtat, obligimet dhe objektivat e veta në fushën e furnizimit të qytetarëve me gjak dhe përbërës të gjakut i realizon duke :

5.1 miratuar planifikimin e nevojave për gjak dhe përbërës të gjakut;

5.2 mbështetur nxitjen e parimeve të vetëmjaftueshmërisë në furnizimin e qytetarëve me përbërës të gjakut përmes dhurimit pa pagesë;

5.3 siguruar kushte për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për nevojën e grumbullimit të gjakut për mjekimin e pacientëve;

5.4 garantuar sigurimin e kushteve për deponimin e gjakut të grumbulluar, testimin, përpunimin e tij si dhe prodhimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e përbërësve të gjakut, në pajtim me zhvillimet shkencore-teknologjike;

5.5 zhvilluar sistemin informativ shëndetësor për fushën e mjekësisë transfuzive;

5.6 mbështetur aktivitete shëndetësore në fushën e mjekësisë transfuzive;

5.7 siguruar kushte për edukimin e personelit në fushën e mjekësisë transfuzive.

Amendamenti 10

Në tërë tekstin e Projektligjit fjala „ Njësitë” zëvendësohet me fjalën „Qendrat”

Amendamenti 11

Në nenin 5, paragrafi 2. riformulohet si vijon :

1. Ushtrimi i veprimtarisë transfuzive, themelimi i qendrave të reja, pezullimi dhe revokimi i autorizimit, bëhet sipas kushteve të përcaktuara me akt nënligjor, të nxjerr nga Qeveria e Kosovës, gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit.

Amendamenti 12

Në nenin 5, paragrafi 3. fjala „aprovimit” zëvendësohet me fjalën „ pëlqimit”.

Amendamenti 13

Në nenin 5, pas paragrafit 4, shtohet një paragraf i ri si vijon:

Institucionet shëndetësore publike, publiko - private dhe private të cilat themelojnë bankën spitalore të gjakut duhet të kenë transfuziologun e tyre.

Amendamenti 14

Në nenin 6, paragrafi 2, fjala „realizon” zëvendësohet me fjalën „përmbush”, dhe në paragrafin 2.1. fjala „ degëve” zëvendësohet me fjalën „Qendrave”

Amendamenti 15

Në nenin 6, paragrafi 2.9 riformulohet si vijon:

2.9. edukimin e vazhdueshëm profesional të personelit në fushën e mjekësisë transfuzive.

Amendamenti 16

Në nenin 6, paragrafi 6. riformulohet si vijon:

6. Organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e QKKTGJ-së, do të përcaktohet me Statutin e QKKTGJ-së, i cili miratohet nga ministri i shëndetësisë.

Amendamenti 17

Në nenin 7, paragrafi 1. në fund të paragrafit shtohet fjalia „, për trajtim transfuziv “.

Amendamenti 18

Në nenin 8, paragrafi 2. riformulohet si vijon:

2. Për themelimin e bankës spitalore të gjakut, institucioni shëndetësor përkatës paraqet kërkesën pranë Ministrisë së Shëndetësisë, duke arsyetuar nevojën e institucionit për themelimin e bankës spitalore të gjakut.

Amendamenti 19

Në nenin 8, paragrafi 4. riformulohet si vijon:

4. Banka spitalore e gjakut licencohet nga Ministria e Shëndetësisë.

Amendamenti 20

Në nenin 8, paragrafi 5. fshihet.

Amendamenti 21

Në nenin 8, paragrafi 6. riformulohet si vijon:

6. Kushtet dhe kriteret për themelimin dhe licencimin e bankës spitalor të gjakut, si dhe kushtet dhe kriteret për ruajtjen e gjakut dhe përbërësve të gjakut, përcaktohen me akt nënligjor të cilin e nxjerrë Ministria e Shëndetësisë.

Amendamenti 22

Neni 9, riformulohet si vijon:

Neni 9 Drejtori i QKKTGJ-së

1. Drejtori i QKKTGJ-së është përgjegjës për:

1.1 menaxhimin dhe administrimin e QKKTGJ-së, nëpërmjet sigurimit të strukturës efikase menaxheriale dhe identifikimit të qartë të niveleve të përgjegjësisë dhe detyrave të punës;

1.2 zhvillimin e QKKTGJ-së dhe qendrave të saja, në përputhje me strategjinë shëndetësore të Kosovës;

1.3 sigurimin e zbatimit të shërbimeve shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor në lëmin e grumbullimit, ruajtjes, testimit, përpunimit, lëshimit dhe shpërndarjes së gjakut dhe përbërësve të gjakut;

2. Drejtori harton dhe mbikëqyrë planin strategjik, zhvillimor, financiar, të personelit, dhe detyrat profesionale dhe specifike tjera të QKKTGJ-së dhe qendrave të saj.

3. Drejtori ofron dhe organizon bashkëpunim profesional me institucionet brenda dhe jashtë Ministrisë, vendore dhe ndërkombëtare në dobi të QKKTGJ-së.

4. Drejtori organizon, mbështet dhe harmonizon promovimin e dhurimit të gjakut në bashkëpunim me Ministrinë dhe institucionet relevante tjera të vendit.

5. Drejtori është përgjegjës për zgjedhjen e udhëheqësve të qendrave transfuzive dhe personelit tjetër brenda QKKTGJ-së.

6. Drejtori i QKKTGJ-së zgjidhet nga Ministria e Shëndetësisë në bazë të konkursit publik .

7. Drejtori duhet ti përmbush kushtet si vijon:

7.1. Të jetë specialist i transfuziologjis

7.2. të ketë së paku 5 vite përvojë pune udhëheqëse në fushën e veprimtarisë transfuzive.

8. Drejtori për punën e tij i raporton Ministrit.

Amendamenti 23

Në nenin 10, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Personi përgjegjës emërohet nga drejtori i QKKTGJ-së, dhe është përgjegjës për:

Amendamenti 24

Në nenin 11, paragrafi 1, fjala „ , , duhet ti “ zëvendësohet me fjalën„, dhe i”

Amendamenti 25

Në nenin 11, paragrafi 2, riformulohet si vijon :

2. Të punësuarit në QKKTGJ dhe qendrat e transfuzionit të gjakut, për punën e tyre marrin shtesë për rrezikshmëri në punë, të paraparë me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria.

Amendamenti 26

Në nenin 14, nën-paragrafi 3.2. pas fjalës „ shëndetësore” shtohet fjalë „ të sigurisë” dhe pas fjalës „kulturore” shtohet fjala „ sportive”.

Amendamenti 27

Në nenin 15, paragrafi 4. në fund të paragrafit fshihet fjala „ nga Ministri” dhe shtohet fjalia „ të nxjerr nga Ministria”.

Amendamenti 28

Neni 17, ndahet në dy paragrafë, si vijon:

1. Numri maksimal i dhurimeve standarde ndalohej të jetë më shumë se katër herë në vit për meshkuj dhe tri herë në vit për femra, kurse intervali në mes dhurimeve standarde duhet të jetë më i madh se 2 muaj për të dyja gjinitë.

2. Përjashtim nga paragrafi 1, bën dhurimi përmes aferezës, ku frekuenca dhe intervali përcaktohen sipas statusit hematopoetik të dhuruesit, me kusht që intervali mes dy dhurimeve duhet të jetë më i madh se 48 orë.

Amendamenti 29

Në nenin 19, paragrafi 2. në fund të paragrafit shtohet fjalia „ të nxjerr nga Ministria”.

Amendamenti 30

Në nenin 23, paragrafi 1. riformulohet :

1. I punësuar i cili dhuron gjak ose përbërës të gjakut, ka të drejtë të marrë 2 (dy) ditë të lira pune, përfshirë ditën e dhurimit.

Amendamenti 31

Në nenin 23, paragrafi 4. në fund të paragrafit shtohet fjalia „ të nxjerr nga Ministria”.

Amendamenti 32

Në nenin 24, paragrafi 3. në fund të paragrafit shtohet fjalia „ të nxjerr nga Ministria”.

Amendamenti 33

Në nenin 25, paragrafi 4. në fund të paragrafit, dhe në nenin 26, paragrafi 3. në fund të paragrafit shtohet fjalia „ të nxjerr nga Ministria”.

Amendamenti 34

Neni 27, riformulohet:

Neni 27

Kushtet e ruajtjes, transportit dhe shpërndarjes së gjakut

1. QKKTGJ obligohet të siguroj kushtet e ruajtjes, transportit dhe shpërndarjes së gjakut, dhe përbërësve të gjakut, në mes të qendrave transfuzive, duke siguruar ruajtjen e integritetit të gjakut dhe përbërësve të gjakut.

2. Kushtet e ruajtjes, transportit dhe shpërndarjes të gjakut dhe përbërësve të gjakut përcaktohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria.

Amendamenti 35

Në nenin 28, paragrafi 1. në fund të paragrafit shtohet fjalia „ sipas legjislacionit në fuqi”.

Amendamenti 36

Në nenin 29, paragrafi 6. në fund të paragrafit shtohet fjalia,, të nxjerr nga Ministria”.

Amendamenti 37

Në titullin e nenit 30, dhe në paragrafin 1, fshihet fjala „shëndetësor” dhe në paragrafin 1, fshihet fjala „ unik”.

Amendamenti 38

Në nenin 30, pas paragrafit 2, shtohet paragraf i ri :

3. Sistemi informativ i QKKTGJ-së, është i veçantë dhe i integruar në Sistemin Informativ Shëndetësor.

Amendamenti 39 - Deputetët Duda Balje dhe Bahrim Shabani- pa përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 32

Lejohet importi/ eksporti i gjakut dhe përbërësve të gjakut në dhe prej Republikës së Kosovës. Gjaku dhe përbërësit e gjakut të importuar/eksportuar duhet t'i plotësojnë të gjitha kriteret e cilësisë dhe sigurisë të parapara me këtë ligj dhe duhet të testohen sipas nenit 25 të këtij ligji.

Amendamenti 40

Në nenin 32, paragrafi 4. pas fjalës „ndërkombëtare “ shtohet fjala „ brenda” .

Amendamenti 41

Në nenin 35, paragrafi 4. fshihet.

Amendamenti 42

Në nenin 35, paragrafi 7, fjala „Ministrinë” zëvendësohet me fjalën „ Ministria në ”

Amendamenti 43

Në nenin 36, paragrafi 3. në fund të paragrafit shtohet fjalia,, të nxjerr nga Ministria”.

Amendamenti 44

Në nenin 38, paragrafi 6. pas fjalës ,, menjëherë” shtohet fjala,, organin kompetent apo”.

Amendamenti 45

Në nenin 38, paragrafi 8. fshihet fjala ,, gojarisht” dhe pas fjalës ,,pëlqimin “ shtohet fjala ,, me shkrim”.

Amendamenti 46

Në nenin 39, paragrafi 7. në fund të paragrafit, dhe në nenin 40, paragrafi 6. në fund të paragrafit, shtohet fjalia ,, të nxjerr nga Ministria”.

Amendamenti 47

Në nenin 43, paragrafi 3. riformulohet si vijon:

1. Inspektimi dhe masat kontrolluese kryhen, së paku një herë në vit.

Amendamenti 48

Në nenin 43, paragrafi 6, fshihet fjala ,, doktor i mjekësisë” dhe ,,10 vite” zëvendësohet me ,, 5 vite”.

Amendamenti 49

Në nenin 44, paragrafi 2, riformulohet:

2. Financimi i QKKTGJ-së bëhet nga:

- 2.1 Buxheti i Republikës së Kosovës;
- 1.2 Nga të ardhurat vetanake për shërbimet e ofruara;
- 1.3 Nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore
- 1.4 Nga kontratat me Kompanitë e Sigurimeve Shëndetësore;
- 1.5 Nga burime tjera.

Amendamenti 50

Në nenin 45, në fund të paragrafit 2.1 shtohet fjalia,, nga organi kompetent” gjithashtu ne paragrafin 2.2. pas fjalës „ vit” shtohet fjalia „ nga organi kompetent”

Amendamenti 51

Në nenin 45, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.2. shuma „ gjashtëdhjetë (60) euro” zëvendësohet me „ njëqind (100) euro”.

Amendamenti 52

Në nenin 45, paragrafi 4 , nën-paragrafi 4.1. shuma dhjetëmijë (10.000) euro” zëvendësohet me shumën „ pesëmijë (5.000) euro”.

Amendamenti 53

Në nenin 45, paragrafi 4 , nën-paragrafi 4.2. shuma njëmijë (1000) euro “ zëvendësohet me shumën „ pesëmijë (5.000) euro”.

Amendamenti 54

Në nenin 45, pas paragrafit 6. shtohet paragraf i ri :

7. Shkeljet ligjor penale, sanksionohen sipas Kodit penal të Kosovës.

Amendamenti 55

Pas nenit 46 shtohet neni i ri :

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ministria e Shëndetësisë brenda gjashtë (6) muajve, nxjerr akte nënligjore, të cilat parashihen me këtë Ligj.

2. Aktet nënligjore në fuqi do të zbatohen deri në afatin e nxjerrjes së akteve nënligjore të përcaktuara me dispozitat e këtij ligji, nëse nuk janë në kundërshtim me këtë ligj.

Komisioni, pas shqyrtimit dhe miratimit të amendamenteve miratoj njëzëri raportin me rekomandime të cilin e procedoj për shqyrtim tek komisionet e përhershme.

Komisioni, po ashtu shqyrtoj propozim amendamentin e deputeteve Duda Balje dhe Bahrim Shabani i cili nuk mori përkrahjen e komisionit.

3. Të ndryshme.

Komisioni, diskutoj që të organizohet aktiviteti për dhurimin e Gjakut brenda Kuvendit të Kosovës me rastin e miratimit të projektligjit në seance dhe ky aktivitet të filloj me dhurimin e gjakut nga anëtarët apo deputetët e komisionit dhe të vazhdoj me deputetët e interesuar për dhurimin e gjakut.

Komisioni, u dakordua që të ftohet për raportin në mbledhjen e radhës Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Besa BAFTIU